



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1899/2 Prot

Tiranë, më 19/12/2023

VENDIM

Nr. 67, datë 19. 12. 2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5, 6, 7, pikës 1 dhe germën c), dh), dhe e) të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me pikën 1 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Komisioneri”) është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji”, si dhe mbështetur në pikën 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku parashikohen kompetencat e Zyrës së Komisionerit, ka kryer monitorimin e transparencës proaktive në faqen zyrtare të Autoritetit Publik “Bashkia Kurbin” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), parashikohet se: “Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të

transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...". Në pikën 3 të nenit 4 të LDI përcaktohet se: "Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik."

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 "Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha këto autoritete publike, duke filluar data 1 janar 2019.

Programi Model i Transparencës, është hartuar në përputhje me nenin 7 të LDI dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës, ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e "Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore".

Bazuar në sa më sipër, gjatë muajit nëntor 2023 Zyra e Komisionerit monitoroi faqen zyrtare të Autoritetit Publik <https://www.bashkiakurbin.gov.al/>, në përfundim të të cilit rezultoi se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 4, nenin 6 dhe nenin 7 të LDI, për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr.211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë.

Konkretisht, nga monitorimi i kryer rezultoi se në faqen zyrtare të Autoritetit Publik gjendet i publikuar programi institucional i transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri, por informacioni sipas fushave dhe rubrikave pjesë përbërëse e tij nuk është i aksesueshëm.

Referuar konstatimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë Autoritetit Publik shkresën nr. 1899 prot., datë 17.11.2023 "*Mbi detyrimet sipas Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" të ndryshuar*", nëpërmjet të cilës, kërkoi marrjen e masave të menjëhershme për publikimin në faqen zyrtare të Autoritetit Publik të të gjitha informacioneve përkatëse në Programin Model të Transparencës. Po ashtu, Zyra e Komisionerit vendosi bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, edhe një raport monitorimi të Programit Model të Transparencës, ku u pasqyruan të gjitha kategoritë e informacioneve që rezultuan të papublikuara në Programin e Transparencës së Autoritetit Publik.

Zyra e Komisionerit njoftoi Autoritetin Publik se duke nisur nga data 27 nëntor 2023, do monitorojë sërish faqen zyrtare të tij duke vijuar me procedurën e hetimit administrativ, në përputhje me nenet 18 dhe 19 të LDI.

Pasi është ri-monitoruar faqja zyrtare e autoritetit publik, është konstatuar se Bashkia Kurbin nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për aksesimin dhe përditësimin me informacion dhe dokumentacion të Programit të Transparencës.

Në këto kushte, në vijim të kësaj procedure, me qëllim ushtrimin e të drejtës për tu dëgjuar, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet komunikimit me e-mail datë 01.12.2023, drejtuar Kryetarit të Bashkisë znj. Majlinda Cara, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seancë dëgjimore, më datë 07.12.2023.

Në seancën dëgjimore morën pjesë përfaqësuesit e Autoritetit Publik: Koordinatorin për të drejtën e informimit dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Pashk Kaci. Sekretari i Përgjithshëm konfirmoi përgjegjësinë e tij për zbatimin e programit të transparencës si nëpunësi më i lartë i Autoritetit Publik, si dhe deklaroi marrjen e masave për publikimin/përditësimin me informacion të rubrikave të programit të transparencës.

Zyra e Komisionerit rimonitoroi sërish faqen zyrtare të Autoritetit Publik dhe rezultoi se deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, nuk është bërë publikimi/përditësimi i kategorive të informacionit të programit institucional të transparencës sipas parashikimeve të LDI.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumentet zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si autoritete publike, mbartin gjithashtu detyrimin e garantimit të së drejtës për informim, si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre.

LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet të publikohet në faqen zyrtare, njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë atë. Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të LDI.

Nga monitorimi i zhvilluar nga Zyra e Komisionerit dhe hetimi i thelluar më pas, rezultoi se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor, si dhe nuk paraqiti asnjë argument apo provë për të arsyetuar mospërmbushjen dhe mos respektimin e dispozitave të LDI.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: “Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”.

Në pikën 2 të nenit 19 të LDI, parashikohet se: “Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, titullari i autoritetit publik mund të delegojë kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1 të nenit 4, pikat 1 dhe 2 të nenit 5, pikën 4 të nenit 7, pikat 1 dhe 2 të nenit 13 të këtij ligji, te nëpunësi më i lartë i autoritetit publik. Në këtë rast nëpunësi, të cilit i është deleguar kompetenca, mban përgjegjësi për shkeljet administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për përditësimin e Programit të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me gërmën “ç/1”, të pikës 2 të nenit 18 të LDI.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në gërmën dh të pikës 2 të nenit 9/1, të gërmës “ç/1”, të pikës 2, të nenit 18, pikën 2 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe gërmën b të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Autoriteti Publik “Bashkia Kurbin”, në zbatim të gërmave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, të mundësojë aksesin dhe të përditësojë Programin Model të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të ligjit, duke patur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të këtij ligji, si dhe sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 27.12.2023.
2. Dënimin e nëpunësit të Autoritetit Publik, z. Pashk Kaci, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Kurbin, në cilësinë e nëpunësit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Bashkisë Kurbin brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, Autoriteti Publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të

ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ky vendim u shpall sot në datë 19. 12. 2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi